



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 61

Prishtinë, më 26.04.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Doruntinë Maloku.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Agnesa Haxhiu- KDI; Luanda Domi- DCAF; Imri Semetishti- ZAP; Agon Foniqi- “Kosova Sot”; Lumnije Murati- ZPRK; Drilon Asllani- Radio “Dukagjini”; Dren Ajeti- GLPS; Sanije Berisha- OSBE; Shefki Kastrati- NDI; Norë Shabani dhe Driton Paçarada- “Koha Ditore”; Endrit Krasniqi- Tribuna channel; Hasan Preteni dhe Blerim Kelmendi- AKK.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kundër Korrupsion, për vitin 2015;
3. Rishqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, për të diskutuar në pikën të ndryshme, rreth një analize buxhetore.

2. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2015

Kryesuesja, në fjalën e saj hyrëse, tha se ashtu si e parasheh ligji, ne kemi përpara raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015, të cilin do ta paraqesë drejtori i kësaj agjencie. Jemi dëshmitar të faktit se të gjithë mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë dhe e gjithë shoqëria kosovare, është e shqetësuar për nivelin e korrupsionit në Kosovë. Më tej, znj. Halimi pyet se në kuadër të këtyre 677 rasteve, a kemi vërtet raste korruptive apo po dominojnë raste, për shkak të deklaramit jo të saktë të pagave, të cilat zyrtarët i marrin përmes xhirollogarisë bankare dhe të cilat raste, në procedura gjyqësore, mbyllen si raste jokorruptive, sepse verifikohet se është bërë lëshim i paqëllimshëm nga ana e zyrtarëve? Sa raste janë që keni ngritur kallëzime penale, për shkak të mos-deklaramit të saktë të pagave dhe të ardhurave tjera që zyrtarët e lartë i marrin përmes xhirollogarive?

Sipas mendimit të qytetarëve, qarkullimet bankare nuk janë shumë shqetësuese, sepse ato mund të verifikohen në çdo moment nga personat kompetentë, por sa shqetësuese janë rastet që mund të kamuflohen dhe nuk mund të gjendet saktë dhe duhet të mbyllen si raste, ndërsa pasuria vërtet e disave rritet në mënyrë marramendëse dhe nuk ka ndonjë arsye për mënyrën e sigurimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë, por jo vetëm të zyrtarëve të nivelit të institucioneve qendrore, lokale, por edhe personave tjerë që lirohen nga deklaramit vjetore të pasurisë, për shkak se nuk bartin pozita të larta zyrtare në institucionet e Kosovës.

Kryesuesja ftoi drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, z. Hasan Preteni, të marrë fjalën.

Hasan Preteni, në fjalën e tij e njoftoi Komisionin me të arriturat dhe sfidat që ka ky institucion. Ndër të tjera, u përmendën risitë në legjislacion, veçmas atij penal, pasi që tani mosdeklarimi i pasurisë është vepër penale dhe agjencia obligohet që të ushtrojë autoritetin ligjor, që këto raste të procedohen në institucionet e drejtësisë. z. Preteni, më tej tha se sa i përket shifrës 677, është shifër komulative, që ka të bëjë me numrin e përgjithshëm të kallëzimeve penale që ka ushtruar agjencia, që nga formimi, e deri në vitin 2015, ku nga Agjencia janë ushtruar 126 kallëzime penale, kundër 189 zyrtarëve. Në këtë kontekst, ai paraqiti të dhëna statistikore në këto vite (2007-2015), që përbëjnë raste të përcjella nga organet kompetente nga agjencia. Kurse, duke folur rreth deklaramit të pasurisë, tha se këtë vit 95.5% e zyrtarëve të lartë e kanë deklaruar pasurinë dhe autoriteti i agjencisë mbulon tërë territorin e vendit. Po ashtu, ai tha se është i nevojshëm ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit. Në këtë rrafsh, u tha se do të duhej të kishte kufizime që zyrtarët e lartë të mos mund të mbajnë disa funksione. Edhe më tej, mbetet prokurimi publik që paraqet një rrezik të fuqishëm, sa i përket korrupsionit, ku përfshihet mosrespektimi i ligjit, në të gjitha fazat, nga përgatitja, publikimi, vlerësimi, lidhja e kontratës dhe zbatimi. Agjencia ka një divizion, që e përcjell këtë fushë dhe përcjell aktivitetet e tenderimit. Po ashtu, paraqet opinione dhe kur vëren se nuk është respektuar Ligji i prokurimit, ushtron kallëzime penale. Si sfida u përmendën: krijimi i bazës së përbashkët të të dhënave, metodologji e përbashkët hetuese, trajnime të përbashkëta, vërtetësia e prejardhjes së pasurisë dhe nevoja e ndryshimit të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kryesuesja ftoi anëtarët e Komisionit që të marrin fjalën.

Armend Zemaj, tha se sa i përket perceptimit të korrupsionit në Kosovë, mendoj se nuk është perceptim, por mendoj se është realitet, sepse edhe në përmbledhjen ekzekutive që është dhënë, ju e keni saktësuar se korrupsioni vazhdon të mbetet dukuri shqetësuese për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe zotimi për përkushtim më të madh, nuk ka arritur të ketë rezultate efikase. Mendoj që detyrat e parashtruara sipas ligjit dhe mandatit që ju e keni, pajtohem me pjesën përmbledhëse që ju e paraqitët. Sa i përket deklarimit dhe parandalimit të konfliktit të interesit, unë mendoj që janë ekzagjeruar deri në momentin kur nuk saktësohen saktë, në mënyrë ligjore, ku do ta bënte ardhja e ligjit, i cili e konfiskon pasurinë e pajustificuar dhe të fituar në mënyrë të paligjshme. Edhe më herët e kam theksuar se mënyra e kontrollit të kësaj pasurie e ka vetëm një efekt pozitiv, sepse mediat, prokuroritë mund të bëjnë krahasimin e këtyre formularëve të deklarimit të pasurisë sesi një zyrtar i lartë e ka krijuar pasurinë e tij përmes këtij krahasimi. Duhet të bëhet nxjerrja e një ligji që e justifikon këtë pasuri të fituar, sepse nëse kjo nuk ndodh, ne mbetemi duke u vërtitur në këtë rreth vicioz, duke folur për mungesën e rezultateve dhe duke folur për mungesën e vendimeve gjyqësore.

Më tej, z. Zemaj ngriti shqetësimin që ka të bëjë me mospublikimin e emrave të personave të dënuar me aktgjykime të plotfuqishme dhe emrat e zyrtarëve që mbajnë disa funksione, njëkohësisht.

Agim Aliu, në fjalën e tij, tha se ky raport nuk jep shpresë për vendin, se edhe nga vetë përmbledhja e raportit shihet qartë se nuk jemi duke luftuar korrupsionin. Z. Aliu ngriti shqetësimin rreth deklarimit të pasurisë, ku me muaj të tërë po merreni me këtë çështje. Më tej, z. Aliu kërkoi që të fuqizohet Agjencia Kundër Korrupsionit, me më shumë staf profesional që e njohin mirë këtë fushë, në mënyrë që të përgatiten lëndët profesionalisht më mirë, që mos të hidhen aq lehtë lëndët nga organet e ndjekjes. Raporti nuk përfshin personat që janë në korrupsion të lartë dhe që e kanë ngulfatur ekonominë dhe zhvillimin e këtij vendi, dhe në këtë mënyrë, kanë dëmtuar dhe po dëmtojnë edhe investimet e jashtme, edhe hapjen e vendeve të reja të punës, po ashtu edhe përmirësimin e mirëqenies sociale në vend. Besoj se është shqetësim edhe i agjencisë, sikurse janë edhe këto shqetësime tona, sepse mendoj se i keni mision dhe qëllim të përbashkët. Prandaj, gjithë këtë që po e flasim, mendoj se i shërben qëllimit sesi të gjejmë rrugën dhe hapat e duhur, në drejtim të luftimit të korrupsionit.

Nezir Çoçaj, tha se pajtohem me atë se çfarë thanë kolegët e mi dhe shqetësimi im është se 29.6% e lëndëve janë hedhur poshtë nga Prokuroria. A mund të dimë pse këto lëndë janë hedhur poshtë apo ndoshta prokurorët kanë njohuri bazike për Ligjin e prokurimit?

Agim Ademaj, në fjalën e tij u shpreh se ka shqetësime për korrupsionin, si dukuri dhe tepër shqetësuese ose më e rrezikshme është tenderomania, si dukuri. Cili është mendimi i juaj, meqenëse jeni edhe në fund të mandatit, mund të na jepni specifikat lidhur me këtë dukuri?

Danush Ademi, kërkoi sqarime rreth hetimit sipas shortit.

Hasan Preteni, lidhur me këto shqetësime që u adresuan nga deputetët, tha se ne nuk publikojmë aktgjykimet e gjykatave, sepse nuk është detyrë e agjencisë. Në fazat që është obligim i agjencisë, ne ruajmë privatësinë e secilit zyrtar. Kurse rreth shqetësimeve për mospublikim të emrave për zyrtarët që mbajnë shumë pozita, tha se këtë ua lejon ligji dhe derisa

nuk ka kufizime ligjore, ne si agjenci, nuk mund të ndërmarrim asnjë veprim. Dhe në fund, duke folur për hetimet në short, tha se nuk mund të hetohet dy vjet radhazi i njëjti zyrtar, por në këto raste vjen personi pas tij.

Meqë nuk kishte diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Anëtarët e Komisionit vlerësuan se raporti mund të procedohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

3. Rishqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;

Kryesuesja paraqiti për rishqyrtim raportin me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe tha se është ngritur si shqetësim i organizatës GLPS, që na është drejtuar edhe ne si komision kryesor, sepse ka futur edhe auditimin e partive politike, në kuadër të ligjit, që në fakt është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse parashihet një formë tjetër e auditimit të partive politike dhe jo ashtu si e kanë paraparë në këtë projektligj. Ky raport me amendamente ka lëshime dhe pikërisht tek **neni 8**, i cili thotë: Konflikti i kompetencave në lidhje me fushëveprimin e këtij ligji do të zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, gjë që e tejkalon Ligjin për procedurën administrative, ku është i qartë definimi i zgjidhjes së konfliktit të kompetencave dhe nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të vendosë për konfliktin e kompetencës në lidhje me fushëveprimin e këtij apo ndonjë ligji tjetër.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç nenit 8 të projektligjit dhe amendamenti 18.
2. I rekomandohet Komisionit Funkcional, që neni 8 i projektligjit dhe amendamenti 18, të hiqen.

4. Të ndryshme

A. Njoftim

Kryesuesja njoftoi anëtarët e Komisionit rreth analizës buxhetore për vitin 2015, që e ka përgatitur Instituti Kombëtar Demokratik, në bashkëpunim me Institutin GAP për institucionet që janë në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion. Po ashtu, kryesuesja tha se në një nga

mbledhjet e ardhshme, do të diskutojmë për këtë analizë buxhetore, ku do të jenë prezent edhe përfaqësuesit e këtyre dy organizatave.

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të jetë më 3.5.2016, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Fatbardha Boletini

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi